



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:058226

Datë: 10.03.2025

Numri i dokumentit: 06966467

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.78/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekalu, me zyrtaren ligjore Artë Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit S.H nga fshati ..., Komuna Klinë, për shkak të veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.2100/2022 të datës 06.03.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 06.03.2025, në praninë e Prokurorit të Shtetit Valon Cërvadiku dhe të pandehurit S.H, në të njëjtën datë shpalli, ndërsa me datë 10.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: S.H, nga i ati R..., e ëma Z..., mbiemri i vajzërisë L..., i lindur me datën ..., me vendbanim në fshatin ..., komuna Klinë, i martuar, bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLET FAJTOR

I. SEPSE: Me datën 13.10.2022 rreth orës 03:40, në rrugën nacionale Mitrovicë-Prishtinë, afër autoservisit "...” në Vushtrri, i pandehuri ishte duke drejtuar automjetin e tipit VW Golf, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..., ku si rezultat i pakujdesisë nën ndikimin e alkoolit 1.77 promilë, e humbë kontrollin mbi automjet duke kaluar në shiritin e kundërt të rrugës dhe me retrovizorin (pasqyrën) e anës së majtë e godet automjetin B, të tipit VË Golf, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..., në retrovizorin (pasqyrën) e anës së majtë, pronë e tani të dëmtuarit E.M, dhe pas

aksidentit i pandehuri nuk ndalon në vendin e ngjarjes, derisa ishte ndaluar nga policia në fshatin
....

Me këtë ka kryer veprën penale *Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur* nga neni 371 par.1 të KPRK-se (Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.06/L-074).

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, dhe 364 të KPPK-së, të akuzuarin,

E G J Y K O N

I. ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese prej një (1) viti.

II. Shpenzimet procedurale në lidhje me këtë çështje bien në barrë të gjykatës.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2100/2022 të datës 06.03.2023, kundër të pandehurit S.H nga fshati ..., Komuna Klinë, për shkak të veprës penale *Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur* nga neni 371 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 06.03.2025, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurori i Shtetit Valon Cërvadiku dhe i pandehuri S.H.

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe sqarimit të benefiteve dhe pasojave të pranimit të fajësisë, të njëjtit i është ofruar mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë. I pandehuri S.H është deklaruar fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, dhe gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen më nuk do të vozisë nën ndikimin e alkoolit dhe nuk do të përsërisë me vepra penale, si dhe që nga kryerja e kësaj vepre penale nuk ka kryer vepra

tjera penale, po ashtu gjykatës i ka propozuar që të merr parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e tij, premtimin se nuk do të kryejë vepra penale dhe gjendjen e dobët ekonomike, si dhe faktin se i njëjti është invalid i luftës.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, pasi që pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, pa presion, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe është në përputhje me nenin 242 të KPRK-së, andaj gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit. Ka shtuar se sa i përket llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit, gjykata të merr parasysh si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, si dhe rrethanat rënduese.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Faktet e çështjes në raport me provat që përmban aktakuza.

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështetin aktakuzën dhe atë: raporti policor, i datës 13.10.2022, kallëzimi penal, i datës 13.10.2022, deklarata e të pandehurit S.H, i datës 14.10.2022, deklarata e të dëmtuarit E.M, 13.10.2022, ekzaminimi i pranisë së alkoolit në gjak, i datës 13.10.2022, dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 4, 7, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe rënduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vite, e në këtë rast gjykata ndaj të akuzuari vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese prej një (1) viti.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të akuzuarin për rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara, e të përmendura nga ana e Prokurorit të Shtetit, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i akuzuari në shqyrtimin fillestar ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, po ashtu ka shfaqur pendimin e tij, për veprën e kryer dhe se nga kryerja e kësaj vepre penale, i pandehuri më nuk ka ra ndesh me ligjin, ndërsa nga rrethanat rënduese gjykata në rastin konkret gjeti shkallën e rrezikshmërisë që paraqet kjo vepër në raport me, dhe duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 46 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të akuzuari të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata erdhi në përfundim se dënimi i shqiptuar është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, pasi që vetë qëllim i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, pasi që gjykata ka vlerësuar se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit, është e nevojshme dhe e mjaftueshme që të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale, si dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Gjykata, shqiptimin e dënimit me kusht e ka bërë në përputhje me nenin 49 par. 1 të KPRK-së, në të cilin përcaktohet se *“Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”*, e që sipas të lartcekurave, vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri, parasheh dënim me burgim deri në 3 vjet, që si përfundim lloji dhe lartësia e dënimit që mund të shqiptohet për këtë vepër, hyn në

kuadër të veprave penale për të cilat mund të shqiptohet dënimi me kusht, ndërsa gjykata nuk ka gjetur arsye që të shqiptoj lloj tjetër të dënimit.

Gjykata vlerësoj edhe propozimi ne prokurorit të shtetit të paraqitur si në aktakuzës, që të pandehurit t'i merret leja e vozitjes, mirëpo gjykata ka gjetur të pabazuar këtë propozim.

Gjykata rithekson kushtet ligjore se kur mund të shqiptohet dënimi për marrjen e lejes së vozitjes, të paraparë si në nenin 65 par. 2 të KPRK-së, ku përcaktohet se *“Gjykata mund të shqiptojë dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni nëse kryesi ka kryer vepër penale duke shkaktuar lëndim të rëndë trupor apo vdekjen e personit ose nëse gjykata konstaton se pjesëmarrja e mëtejshme e kryesit në trafikun publik është e rrezikshme për sigurinë e trafikut publik për shkak të paaftësisë së tij për drejtimin e sigurt të automjetit”*.

Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite, del se gjykata mund të shqiptoj dënimin për marrjen e lejes së vozitjes, kur me veprën penale që rrezikon sigurinë e trafikut publik, i pandehuri me veprën e tij penale ka shkaktuar pasojat e më poshtme:

- a). Ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor,
- b). Është shkaktuar vdekja e personit, ose
- c). Nëse gjykata konstaton se pjesëmarrja e mëtejshme e kryesit në trafikun publik është e rrezikshme për sigurinë e trafikut publik për shkak të paaftësisë së tij për drejtimin e sigurt të automjetit.

Duke analizuar kushtet e sipërcituara, gjykata ka gjetur se nuk është plotësuar asnjëri nga këto kushte, ngase vepra penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor, nuk ka krijuar pasojën e lëndimit të rëndë trupor apo vdekjen e personit të tretë, si dhe prokurori i shtetit me asnjë provë nuk ka argumentuar paaftësinë e të pandehurit për drejtimin e sigurt të automjetit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 452 par. 4 të KPPK-së, duke e liruar të pandehurin nga të gjitha shpenzimet e procedurës penale, pasi që i pandehuri është invalid i UCK-së, dhe me pagesën e këtyre shpenzimeve, do të rrezikohej gjendja e tij materiale ose e personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.78/2023, datë 10.03.2025

Zyrtarja Ligjore
Arta Jusufi

Gj y q t a r i
Naim Rekalio

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimet të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.